

Falënderimi i takon Allahut, kurse pagja, lavdërimi dhe bekimi i Allahut qofshin me të Dërguarin tonë, Muhamedin, me familjen e tij, shokët e tij dhe me të gjithë ata që e pasojnë.

Gjatë këtyre ditëve e gjithë bota po e ndjek luftën e ashpër që po e bën shteti i jehudëve, në bashkëpunim me shtetet e kufrit (mosbesimit) dhe agjentët e tyre në rajon, kundrejt vëllezërve tanë të shtypur në Rripin e Gazës. Armiku me tiraninë më të madhe dhe terror të paparë po ushtron egërsinë e tij ushtarake duke vrarë, shkatërruar dhe qëlluar qytetarët, përfshirë këtu gratë, fëmijët, xhamitë, strehimoret, spitalet dhe shkollat. Kjo luftë erdhi si shkak i rrethimit të padrejtë politik dhe ekonomik, nga i cili po vuan për më shumë se shtatë vjet Rripi i Gazës. Synimi i tërë kësaj ishte nënshtrimi i këtij vendi të qëndrueshëm ndaj vullnetit të jehudëve pushtues, dobësimi i banorëve të tij dhe çrrënjësia e shpirtit të xhihadit dhe rezistencës nga ky vend dhe banorët e tij.

Kurrsesi nuk u lejohet muslimanëve të heshtin ndaj kësaj fatkeqësie e as të preokupohen me çështje tjera të mëdha, që kanë të bëjnë me vendin tonë, duke lënë anash këtë çështje, sepse muslimanët janë si një trup; muslimani gëzohet për gëzimin e vëllait të vet dhe pikëllohet për pikëllimin e tij, madje muslimanët bëjnë gara për të ndihmuar njëri-tjetrin me të gjitha llojet e mundshme të ndihmesës pa përtuar dhe pa u ngadalësuar, duke zbatuar kështu fjalën e Allahut të Plotfuqishëm: **"Besimtarët dhe besimtare janë miq për njëri-tjetrin"**. [Et-Teube, 71].

Për këtë arsye, nënshkruesit e kësaj deklarate, duke dashur të zbatojnë amanetin që e ka marrë Allahu prej tyre dhe obligimin për të ndihmuar banorët e Gazës, japin mesazhet vijuese:

Mesazhi i parë: Drejtuar vëllezërve tanë të palëkundshëm në Gaza, duke përfshirë pleqtë, gratë dhe fëmijët, të cilët i nxisim të vazhdojnë me qëndrueshmërinë, lavdinë, forcën dhe sakrificën e tyre të madhe dhe njëherazi i porosisim të pajisen me durim, devotshmëri dhe ibadet ndaj Allahut, siç thotë Allahu i Lartësuar: **"Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz!"** [El-Bekare, 45] Sepse **"Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë punëmirë"**. [En-Nahël, 128] Atij, me të cilin është Allahu, aspak nuk i bën dëm kurthi i armikut, siç thotë Allahu i Lartësuar: **"Nëse ju duroni dhe ruheni nga gjynahet, dinakëritë e tyre nuk mund t'ju dëmtojnë aspak"**. [Ali-Imran, 120] Dhe, siç thotë i Dërguari i Allahut, Muhamedi, lavdërimi dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të: *"Vërtet, Allahu e ndihmon këtë umet me të dobtët e tyre; me lutjet, namazin dhe çiltërsinë e tyre"*. [Këtë hadith e shënon Nesaiu, kurse Albani e cilëson si të shëndoshë (sahih)].

Prej fryteve të durimit dhe devotshmërisë janë: Mbështetja e çiltër në Allahun, të drejtuarit nga Ai për të gjitha çështjet, kërkimi i ndihmës nga Ai dhe strehimi i vërtetë tek Ai me lutje, duke zbatuar kështu urdhrin e Allahut, në të cilin thuhet: **"Lutmuni Mua, se do t'ju përgjigjem!"** [Gafir, 60] Dhe, duke ndjekur shembullin e të Dërguarit të Allahut. Prandaj, thoni sikurse thoshte i Dërguari i Allahut: *"Allahu ynë, o zbritës i Librit, lëvizës i reve, mposhtës i grupimeve, mposhti ata dhe ndihmona kundër tyre"* [Buhariu dhe Muslimi].

Shpresojmë të bëni pjesë të madhe në fjalën e të Vërtetit, të Madhërishmit: **"Sa e sa profetë bashkë me shumë besimtarë të vërtetë luftuan e megjithatë nuk u përkulën para goditjeve që morën në rrugën e Allahut, as nuk u dobësuan e as nuk u nënshtruan. Allahu i do të duruarit."** [Ali-Imran, 146]

Ju porosisim të jini mburojë dhe mbështetje për heronjtë e rezistencës, të qëndroni me ta krah për krah, t'i mbronin nga mbrapa, t'ua ruani familjet atyre, kur ata nuk janë të pranishëm, dhe t'ua këpusni rrugën shkatërrimtarëve, të cilët duan t'i përçajnë radhët tuaja dhe t'jua prishin unitetin. Andaj, ju porosisim me fjalën e Allahut: **"Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani!"** [Ali-'Imran, 103]

Mesazhi i dytë: Këtë mesazh ua drejtojmë muxhahidëve të pathyeshëm në fushëbetejë, të cilët tronditën sionistët, madje tërë botën, me qëndrueshmërinë e tyre të pamposhtur dhe veprat e tyre heroike, dhe treguan trimëri të rrallë duke qëndruar të pathyeshëm në fytyrë të armikut dhe arritjen e tyre për të zhvendosur betejën në thellësinë e sionistëve dhe mbrapa radhëve të tyre. Ne i porosisim ata me fjalët, me të cilat i porosi Allahu muxhahidët që luftojnë në rrugën e Tij: **"O besimtarë, kur të ndesheni me ndonjë forcë armike, qëndroni të patundur dhe përmendni shumë Allahun që të fitoni."** [El-Enfal, 45] Kini mendim të mirë për Allahun e Plotfuqishëm, kijeni në synim vetëm Allahun dhe ndihmoheni Atë, duke iu bindur Atij, duke i zbatuar urdhrat e Tij dhe duke u ndaluar nga gjërat që na i ka ndaluar, **"Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm"**, [El-Haxh, 40] **"Është detyra jonë që t'i ndihmojmë besimtarët"**. [Er-Rrum, 47] Atyre që u ndihmon Allahu, nuk u bën dëm kundërshtimi që ua bëjnë kundërshtarët e as tradhtia që ua bëjnë tradhtarët. Andaj, mos ia vini veshin thirrjeve të kundërshtarëve, me të cilat zhurmojnë mediet tona dhe skena jonë politike. **"(Ata) të cilëve njerëzit (hipokritë) u thanë: "Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni!" e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: "Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!"**" [Ali-'Imran, 173]

Meqenëse kjo betejë e përgjakshme është vendimtare në historinë e konfliktit me armikun sionist dhe aleatët e tij, porosisim krahun politik të rezistencës të jenë të qëndrueshëm në këtë çështje dhe të mos dorëzohen ndaj presionit të vazhdueshëm nga brenda dhe jashtë. Derisa armiku nuk ka mundësi t'jua thyejë qëndrueshmërinë tuaj në fushëbetejë, mos lejoni që t'jua thyejë atë përmes negociatave politike. Kujtoni porositë e Zotit tuaj, i Cili thotë: **"Mos u tregoni të dobët në ndjekjen e jobesimtarëve! Nëse ndjeni dhembje prej luftës, edhe ata ndiejnë dhimbje ashtu si edhe ju. Mirëpo ju shpresoni prej Allahut atë që ata nuk e shpresojnë. Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë."** [En-Nisa, 104] **"Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë."** [Ali-'Imran, 139]

Në këtë drejtim, ne theksojmë se është tejet e rëndësishme që vëllezërit tanë muxhahidë në Gaza të jenë vigjilentë kundrejt kurthave të armikut safevit iranian dhe punëtorëve të tyre siç është *"Hizbu'l-Lat"*, i cili mund ta shfrytëzojë tradhtinë e qeverive arabe për të ndihmuar vëllezërit e tyre, në mënyrë që të fitojnë me disa qëndrime të tyre simpatinë e disa të shkujdesurve nga bijtë e umetit tonë. Ai është armiku që ua shfaq dhembët vëllezërve tanë në Siri dhe Irak, si t'u besojmë atëherë atyre pas gjithë kësaj?! O muxhahidë, shkëputni zemrat tuaja me krijesat dhe lidhni ato me Krijuesin, duke marrë në të njëjtën kohë shkaqet e lejuara.

Mesazhi i tretë: Këtë mesazh ua dërgojmë muslimanëve në përgjithësi. Ne ua kujtojmë atyre hakun e vëllazërisë islame, meqë sikurse thotë Allahu **"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër."** [El-Huxhuratë, 10] Gjithashtu, i Dërguari ynë, Muhamedi, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të thotë: *"Shembulli i besimtarëve në dashurinë, mëshirën dhe dhembshurinë që*

kanë mes tyre është sikurse shembulli i një trupi të vetëm, në qoftë se ankohet një gjymtyrë i tërë trupi vuan nga pagjumësia dhe ethet". [Muslimi]. Vëllazëria është një lidhje madhështore e imanit, e cila bashkon gjymtyrët e trupit të muslimanit. Frytet e saj janë: përkrahja, ndihmesa dhe përpjekja për largimin e zullumit me të gjitha shkaqet e mundshme. Prej shkaqeve më madhështore është të drejtuarit Allahut me lutje, po ashtu duke bërë dua të kunutit në të gjitha namazet dhe duke shpejtuar për të ndihmuar banorët e Gazës materialisht dhe moralisht me të gjitha llojet e ndihmës. Është përcjellë nga i Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, të ketë thënë: "Gjaku i muslimanëve është i barabartë, hakun e tyre e kërkon ai që është më i dobët, kurse ua kthen atë ai që është më i fortë, dhe ata janë si një dorë e bashkuar kundër të tjerëve". [Hadithin e shënojnë Ebu Davudi dhe Nesaiu, kurse Albani e cilëson si të shëndoshë].

Moskryerja e këtij obligimi si duhet është prej shkaqeve të trazirave dhe shkatërrimit. Allahu i Lartësuar thotë: **"Kurse jobesimtarët janë miq e mbrojtës të njëri-tjetrit. Nëse nuk veproni ashtu siç jeni urdhëruar, do të bëhet ngatërresë dhe shkatërrim i madh në Tokë."** [El-Enfal, 73] Imam Taberiu, shpjegon se ky ajet ka këtë kuptim: "Në qoftë se nuk e bëni atë që ju urdhëroj për të përkrahur dhe ndihmuar njëri tjetrin në fe, do të ketë trazira në tokë".

Sot po e shohim se si po bashkohen fuqitë më të mëdha botërore për të mbështetur thjeshtren e tyre, shtetin e armikut sionist, siç bëhet me dije nga Senati Amerikan, se kupola e hekurt është mbështetur me një shumë prej 225 milionë dollarësh. Kjo na detyron neve t'ia shtrojmë një pyetje të madhe botës arabe dhe asaj islame, në të cilën thuhet: Sa e madhe është mbështetja jonë në botën arabe për të rindërtuar atë që është shkatërruar, për të mjekuar të plagosurit dhe për të ngushëlluar banorët e Gazës?! Muslimanëve u takon më shumë ta ndihmojnë njëri tjetrin! Madje, nuk bën ta kufizojmë ndihmon tonë vetëm në kohën e luftës, ngaqë plagët janë tepër të mëdha dhe nevoja e tyre është shumë e madhe. Jemi të obliguar të vazhdojmë t'i ndihmojmë ata, për t'ua shuar dhembjet dhe për t'ua pakuar plagët. Mbase, në fazën e pasluftës nevoja mund të jetë edhe më e madhe. Allahu i Madhërishëm thotë: **"Ja, juve ju bëhet thirrje të shpenzoni në rrugën e Allahut, por disa prej jush janë koprracë. Kush tregohet koprrac, ta dijë se i bën dëm vetes, sepse Allahu është i Pasur (s'ka nevojë për asgjë), ndërsa ju jeni të varfër. E, nëse ju ia ktheni shpinën dhe i largoheni Atij, Ai do t'ju zëvendësojë me një popull tjetër, i cili nuk do ta ndjekë shembullin tuaj".** [Muhammed, 38].

Mesazhi i katërt: Këtë mesazh ua drejtojmë dijetarëve dhe thirrësve të umetit, duke ua kujtuar atyre përgjegjësinë e madhe që kanë përpara Allahut të Plotfuqishëm për të ndihmuar të shtypurit dhe për të dhënë mundin e tyre për të ndalur dhe për të zmbrapsur zullumqarët, kushdo qofshin ata, dhe njëherazi për të sqaruar të vërtetën rreth kësaj çështjeje pa hezitim dhe pa u ngadalësuar. Çfarë hajri mund të ketë në atë njeri që i sheh eshtrat e muslimanëve të shkapërderdhura dhe gjakun e tyre duke rrjedhur si lumenj, kurse ai qëndron gjakftohtë dhe me gjuhë të heshtur?!

Mbështetja e umetit tonë në dijetarë dhe thirrës është e madhe. Ne lusim Allahun t'i mbrojë ata nga kërcënimi i Allahut dhe kërcënimi i të Dërguarit të Tij, lavdërimi dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, për atë që e fsheh dijen dhe e fsheh të vërtetën ose që u bën shtrembërime muslimanëve dhe i ndihmon zullumqarët qoftë edhe me gjysmë fjale.

Sikurse që përgjegjësia e dijetarëve dhe thirrësve është shumë e madhe po ashtu edhe

pasanikët dhe gazetarët nga bijtë e umetit tonë kanë një përgjegjësi të madhe për përmbushjen e nevojave të banorëve të Gazës dhe për mbështetjen e tyre dhe po ashtu për të penguar dëmin që ua bëjnë atyre mendjelehtët.

Mesazhi i pestë: Këtë mesazh ua drejtojmë sionistëve arabë, të cilët gëzohen për fatkeqësinë e rezistencës dhe përpigën ta shëmtojnë imazhin e saj. Për të tillët Allahu thotë: **"Ti i sheh ata me zemra të sëmura, sesi vrapojnë për t'u lidhur me ata (hebrenjtë) duke thënë: "Druajmë se mos po na godet ndonjë fatkeqësi".**" Ne u themi atyre, siç thotë Allahu i Plotfuqishëm: **"Mbase Allahu do të sjellë fitore ose diçka tjetër nga ana e Tij, kështu që ata do të pendohen për atë që kanë fshehur në veten e tyre."** [El-Maide, 52] Me lejen e Allahut, së shpejti do të pendoheni për qëndrimet tuaja të turpshme.

Ndërsa, muslimanëve në përgjithësi u themi: Gaza ua shfaqti fytyrën e shëmtuar këtyre munafikëve nga udhëheqësit, intelektualët dhe gazetarët. Gjithashtu ju bëjmë me dije se shumica e këtyre qëndrimeve të turpshme nuk janë thjesht vetëm për të kundërshtuar një fraksion të caktuar politik, por kjo është tradhti ndaj umetit, rënie në kënetën e varësisë dhe të miqësimi me armiqtë që na luftojnë. Falënderimi i takon Allahut që shfaqti prishjen dhe mashtrimin e tyre. Mbase në këtë luftë mund të ketë të mira të shumta, siç thotë Zoti ynë i Plotfuqishëm: **"Është e mundur që juve të mos ju pëlqejë diçka, por që Allahu në atë do t'ju sjellë shumë të mira"**, [En-Nisa, 19] sikurse që është dhënia shpresë umetit se ajo ka forcë të ballafaqohet me armikun më të vështirë (jehudët) dhe shfaqja e armiqve invalidë e të fshehur (munafikëve).

Mesazhi i gjashtë: Ky mesazh u drejtohet qeverive të rajonit. Ne u themi atyre t'i frikësohen Allahut për komplotin që po e bëjnë me armikun sionist dhe për tradhti ndaj muslimanëve të shtypur e të dobët, sepse i Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Atë njeri që tradhton ndonjë musliman në ndonjë vend, duke prekur nderin e tij a duke cenuar shenjtërinë e tij, Allahu do ta tradhtojë atë në një vend ku do të dëshirojë ta ndihmojë Allahu"*. [Këtë hadith e shënojnë Imam Ahmedî dhe Ebu Davudi, kurse Albani e cilëson si *hasen* (të mirë)].

Në të kaluarën dëgjonim nga ju denoncime dhe mospajtime, ndërsa tashmë po e shohim që disa nga ju kanë hequr dorë edhe nga kjo gjë e pakët, madje po e shfaqin haptazi tradhtinë e tyre dhe bashkëpunimin me armikun. Andaj, ne ju paralajmërojmë nga bërja zullum dhe përfundimi i tij me fjalët e Allahut: **"Sigurisht, do të humbë ai që do të mbartë padrejtësi"**. [Ta ha, 111].

Ne, së bashku me të gjithë muslimanët, i bëjmë thirrje qeverisë së Egjiptit që ta hapë shpejt dhe përgjithmonë vendkalimin kufitar të Rafahut dhe ta thyejë bllokadën e padrejtë në Rripin e Gazës. Bllokimi i përhershëm, edhe po të mos ishte në kohëra të vështira sikurse kjo, do të numërohej zullum i madh, tradhti e madhe, komplot me armikun që lufton kundër nesh dhe qëndrim në radhët e tyre kundër umetit, e si është puna në këtë sprovë të hidhur?!

Gjithashtu, ua kujtojmë të gjitha qeverive se planet e kryqtarëve, të sionistëve dhe të safevive në rajon nuk do ta përjashtojnë askënd, andaj shmangeni nga vetja poshtërimin e dunjasë para se t'ju vijë dënimi i botës tjetër!

Për fund, i themi botës mbarë: Neve, në çdo fatkeqësi nëpër të cilën kalon ky umet e posaçërisht në çështjen e Palestinës, vetëm sa na shtohet bindja për racizmin e shumicës së qeverive perëndimore dhe të organizatave të kombeve të ndryshme, dhe për standardet dhe vlerat e tyre të dyfishta dhe i kuptojmë gënjeshttrat e tyre, të cilat i përsërisin vazhdimisht, siç janë parullat për të drejtat e njeriut e të ngjashme. Përndryshe, çfarë kuptimi ka heshtja ndaj krimeve të luftës, vrasjeve dhe gjenocidit që po e bëjnë sionistët para syve dhe veshëve të botës?! Madje, perëndimi po e tejkalon heshtjen duke i mbështetur ata materialisht dhe me pjesëmarrje të njerëzve të tyre në luftë bashkë me sionistët kundër muslimanëve në Gaza, siç është raportuar në media!

A nuk ka ardhur koha që të mençurit e botës të dalin përballë padrejtësisë dhe t'i ngritin zërat me plot guxim për ta thënë të vërtetën dhe për ta zbatuar drejtësinë?!

Lusim Allahun të largojë vështirësitë dhe belanë nga vëllezërit tanë në Gaza dhe nga të gjithë vëllezërit tanë të shtypur në Sham (Siri), në Irak, në Libi dhe në Jemen dhe të zbresë dënimin e Tij mbi popullin kriminel! E lusim Atë gjithashtu ta përmirësojë gjendjen e muslimanëve, ngase Ai ka mundësi dhe fuqi ta bëjë këtë! Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi peygamberin tonë, Muhamedin dhe mbi familjen dhe shokët e tij.

Më 07.10.1435 h. (04.08.2014)

Burimi: <http://almoslim.net/node/215340>

Në shqip: Shembulli.com

Emrat e nënshkruesve të kësaj deklarate:

1. Shejh Dr. Abdullah ibn Muhamed El-Gunejman
2. Shejh Dr. Muhamed ibn Nasir Es-Suhejbanij
3. Shejh Dr. Abdurahman ibn Salih El-Mahmud
4. Shejh Sulejman ibn Vail Et-Tuvejxhiri
5. Shejh Prof. Dr. Nasir ibn Sulejman El-Umer
6. Shejh Prof. Dr. Sead ibn Abdullah El-Humejd
7. Shejh Ahmed ibn Abdullah Al Shejban
8. Shejh Dr. Abdullah ibn Hamd El-Xhelali
9. Shejh Dr. Ahmed ibn Abdullah Ez-Zahrani

10. Shejh Dr. Muhamed ibn Seid El-Kahtani
11. Shejh Prof. Dr. Sulejman ibn Hamed El-Audeh
12. Shejh Prof. Dr. Alij ibn Seid El-Gamidij
13. Shejh Dr. Abdulaziz ibn Abdul-muhsin Et-Turkij
14. Shejh Dr. Ibrahim ibn Nasir En-Nasir
15. Shejh Prof. Dr. Sulejman ibn Kasim El-Ijd
16. Shejh Dr. Halid ibn Abdurahman El-Uxhejmi
17. Shejh Fehd ibn Sulejman El-Kadij
18. Shejh Fehd ibn Muhamed ibn Asakir
19. Shejh Muhamed ibn Sulejman El-Mesud
20. Shejh Dr. Abdullah ibn Abdurahman El-Vetban
21. Shejh Dr. Hasen ibn Salih El-Humejdi
22. Shejh Dr. Abdulaziz ibn Muhamed Al Abdil-Latif
23. Shejh Sead ibn Nasir El-Gannam
24. Shejh Abdullah ibn Fehd Es-Selumij
25. Shejh Abdullah ibn Nasir Es-Sulejman
26. Shejh Alij ibn Ibrahim El-Muhejsh
27. Shejh Dr. Muhamed ibn Abdulaziz El-Hudejri
28. Shejh Dr. Muhamed ibn Abdullah Ed-Dujejsh
29. Shejh Prof. Dr. Abdurahman ibn Xhemil Kasas
30. Shejh Dr. Salih Abdullah El-Hedhlul
31. Shejh Dr. Muhamed ibn Abdullah El-Hudejri
32. Shejh Dr. Sulejman ibn Muhamed ibn Abdullah El-Uthejm

33. Shejh Alij ibn Ahmed Alu Is-hak
34. Shejh Ibrahim ibn Abdurahman Et-Turkij
35. Shejh Dr. Musfir ibn Abdullah El-Bevardij
36. Shejh Dr. Abdulaziz ibn Abdullah El-Mubdel
37. Shejh Dr. Abdullah ibn Abdulaziz Ez-Zajidi
38. Shejh Abdurahman ibn Abdulaziz Ebanmij
39. Shejh Hamed ibn Ibrahim El-Hajderij
40. Shejh Ahmed ibn Abdurahman Ez-Zuman
41. Shejh Dr. Abdullah ibn Nasir Es-Subejh
42. Shejh Abdurahman ibn Alij El-Mushejkih
43. Shejh Sulejman ibn Abdullah Es-Suvejd
44. Shejh Mahmud ibn Ibrahim Ez-Zahranij
45. Shejh Mesud ibn Husejn ibn Sahnun
46. Shejh Dr. Muhamed ibn Abdulaziz El-Lahim
47. Shejh Prof. Dr. Nasir ibn Jahja El-Hunejni
48. Shejh Muhamed ibn Abdulaziz El-Maxhid
49. Shejh Abdulaziz ibn Abdullah El-Vuhejbi
50. Shejh Abdullah ibn Alij Er-Rabi'
51. Shejh Abdullah ibn Umer Es-Suhejbani
52. Shejh Ahmed ibn Muhamed Bathaf
53. Shejh Xhemaz ibn Abdurahman El-Xhemaz
54. Shejh Dr. Ibrahim ibn Muhamed Abas
55. Shejh Dr. Halid ibn Muhamed El-Maxhid

56. Shejh Dr. Nasir ibn Muhamed El-Ahmed
57. Shejh Hamud ibn Dhafir Esh-Shihrij
58. Shejh Dr. Sulejman ibn Abdullah Es-Sejf
59. Shejh Alij ibn Jahja El-Karafij
60. Shejh Isa ibn Dirzij El-Meble'
61. Shejh Abdullah ibn Alij El-Gamidij
62. Shejh Abdullah ibn Abdulaziz El-Mubrid
63. Shejh Abdulmelik ibn Alij El-Muhsin
64. Shejh Umer ibn Abdulaziz El-Kubejsi
65. Shejh Hamdan Abdurahman Esh-Sherkij
66. Shejh Abdulaziz Abdullah El-Vuhejbi
67. Shejh Ahmed ibn Salih Es-Samani
68. Shejh Halid Muhamed El-Burejdi
69. Shejh Sad ibn Alij El-Umerij
70. Shejh Muhamed ibn Seid Bafil
71. Shejh Ibrahim ibn Hadran Ez-Zahrani
72. Shejh Salim ibn Faiz El-Halaf
73. Shejh Ahmed Abdullah Er-Raxhihi
74. Shejh Fehd ibn Nasir El-Harbij
75. Shejh Ahmed ibn Abdullah Er-Rubejsh
76. Shejh Abdullah ibn Muhamed El-Burejdi
77. Shejh Feuzan ibn Abdullah El-Feuzan
78. Shejh Rashid ibn Abdulaziz El-Humejd
79. Shejh Muhamed ibn Abdulaziz El-Gufejli

- 80. Shejh Abdullah ibn Sulejman El-Umejranij
- 81. Shejh Uthman ibn Abdurahman El-Humejdan
- 82. Shejh Hamed ibn Sad Eth-Thubejti
- 83. Shejh Abdullah ibn Alij El-Hetani
- 84. Shejh Abdulaziz ibn Muhamed En-Nugejmeshi
- 85. Shejh Muhamed ibn Mubarek ibn Xherbu'ë
- 86. Shejh Hamed ibn Ibrahim El-Ubejdij